

INFORMACIONE RRETH KARRIERËS

Gjatë procesit të orientimit nxënësit duhet të inkurajohen të marrin përgjegjësi për të hulumtuar alternativat për karrierën që janë të disponueshme dhe të mundshme. Një pjesë e madhe e kërkimeve mund të bëhet në mënyrë individuale, nëse nxënësit kanë mundësi të kenë informacion brenda në shkollë ose jashtë saj. Informacioni mund të jetë në forma të ndryshme: libra, internet dhe audio-viziv.

Informacionet e ofruara në shkollë në lidhje me karrierën

Është e rëndësishme që shkollat të ofrojnë informacion për karrierën dhe kalimin nga shkolla tek puna për nxënësit e tyre me qëllim që ata të kryejnë vetë pjesën më të madhe të punës kërkimore. Kjo është vetëm një nga mënyrat se si mund të motivohen të rinjtë për të marrë përgjegjësi për planifikimin e karrierës së tyre dhe është një element shumë i rëndësishëm i procesit.

Informacioni që duhet të ketë shkolla për nxënësit në lidhje me karrierën:

- Si të hulumtojmë në lidhje me karrierën;
- Si të aplikojmë për punë ose kualifikim;
- Si të zgjedhim universitetin;
- Si të kërkojmë për punë vullnetare/punë apo udhëtime jashtë vendit/aktivitete të tjera.

Ky informacion mund të jetë në forma të ndryshme:

1- Materiale me shkrim (për kërkime në lidhje me karrierën)

- Libra për karrierën;
- Gazeta dhe revista biznesi;
- Informacion për zhvillimin e aftësive të punësimit;
- Materiale shpjeguese se si të shkruajmë një CV, letër aplikimi;
- Informacione për planifikimin e karrierës;
- Broshura dhe materiale promocionale të organizatave në lidhje me punësimin.

2- Interneti dhe materiale elektronike

- Faqe interneti të universiteteve;
- Faqe interneti të njoftimeve të punësimit;
- Faqe interneti të punëdhënësve të mëdhenj;
- Informacion për vetë-punësimin.

3- Materiale vizive

- Video për zhvillimin e aftësive të punësimit;
- Video dhe DVD me informacione për arsimin e lartë dhe punëdhënësit.

Ofrimi i informacionit për punën, avancimin në karrierë, zhvillimin e aftësive të planifikimit etj., mbështet procesin e orientimit. Mësuesit, psikologët apo këshilluesit e karrierës duhet të njohin rëndësinë e hulumtimit personal sepse kjo do të motivojë

nxënësit që të marrin përgjegjësi për investigimin e alternativave dhe mënyrave të përmirësimit të aftësive të tyre planifikuese. Në ato shkolla, ku ka biblioteka dhe internet, nxënësit kanë më shumë mundësi që të marrin përgjegjësi për të shtuar njohuritë e tyre në lidhje me botën e punës.

SHEMBULL

Mendoni për një nxënës, i cili dëshiron të dijë se si të bëhet mësues

Në këtë shembull ju mund të mendoni në lidhje me nivelin e mbështetjes për të cilin një nxënës ka nevojë me qëllim që të marrë një vendim realist për karrierën e tij.

Informacioni

Nëse një nxënës kërkon informacion se si të bëhet mësues, ai mund të kërkojë informacion për të lexuar i cili do ta ndihmonte për të marrë në konsideratë argumentet pro dhe ato kundër për veten e tij me qëllim që të marrë një vendim realist. Në këtë rast mësuesi i jep nxënësit informacion në lidhje me mënyrat se si ai/ajo mund të bëhet mësues. Informacioni mund të jepet me gojë ose me materiale të printuara. Përgjegjësia qëndron tek nxënësi për të lexuar informacionin dhe për të vendosur nëse ka informacion të mjaftueshëm për të marrë një vendim.

Përgjegjësia: nxënësi me mbështetjen e mësuesit.

Këshilla

Pasi ka marrë informacionin, nxënësi mund të dëshirojë të diskutojë disa prej shqetësimeve që mund të ketë. Ai mund të ketë shqetësime për rezultatet e arritura dhe mund të dëshirojë të sigurohet që është i aftë të arrijë aty ku dëshiron nëse punon mirë në shkollë. Ai gjithashtu mund të ketë nevojë për këshilla për informacionin që ka marrë.

Mësuesja mund t'i shpjegojë nxënësit argumentet pro dhe kundër rreth vazhdimin të shkollës për t'u bërë mësues pa dhënë një opinion në lidhje me mënyrën më të përshtatshme për t'a arritur atë.

Përgjegjësia: nxënësi ka nevojë të diskutojë çështjet e përmendura më sipër me mësuesin, i cili do të jetë i aftë t'i japë atij këshilla. Pas sesionit të këshillimit, nxënësi duhet të vendosë nëse ai ka shqetësime të tjera, për të cilat ka nevojë të hulumtojë më në thellësi.

Orientimi

Mund të jetë një ide karriere e cila ka nevojë për diskutim të mëtejshëm ose analizë më në thellësi, dhe nëse ky është rasti, nxënësi duhet t'i drejtohet psikologut ose këshilluesit të karrierës (nëse ka). Psikologu/këshilluesi do të diskutojë me nxënësin argumentet pro dhe rreth secilës mënyrë dhe ta lidhë këtë me rrethanat personale me qëllim që ta ndihmojë nxënësin të vendosë se cila rrugë është më e përshtatshme për të. Diskutimi duhet të jetë tërësisht objektiv.

Përgjegjësia: nxënësi do të duhet të drejtohet tek psikologu ose këshilluesi i karrierës për këtë nivel mbështetjeje.

Fleta e punës 1

Informacion, këshilla dhe orientim

Mendoni në lidhje me kërkesat e mëposhtme që ju mund të merrni nga nxënësit për të vendosur në lidhje me informacionin, këshillat dhe orientimin, për të cilin ato mund të kenë nevojë në lidhje me planifikimin për karrierën.

Një nxënës ka kërkuar ndihmë për shkak se ai/ajo do të donte të punonte në bankë kur të mbarojë shkollën, por është i shqetësuar për rezultatet e provimeve.

Çfarë informacioni duhet t'i jepni?

Çfarë këshillash duhet t'i jepni?

Për çfarë lloj orientimi mund të ketë nevojë (duke marrë parasysh që mund të jetë duke pasur vështirësi me mësimet në shkollë)?

Fleta e punës 2

Informacion, këshilla dhe orientim

Mendoni në lidhje me kërkesat e mëposhtme që ju mund të merrni nga nxënësit për të vendosur në lidhje me informacionin, këshillat dhe orientimin, për të cilin ato mund të kenë nevojë në lidhje me planifikimin për karrierën.

Një nxënës ka kërkuar ndihmë për shkak se ai/ajo do të donte të punonte kamerier/e për shkak se familja e tij/saj ka probleme financiare dhe nëse ai/ajo ka një punë me kohë të pjesshme si kamerier/e mund të vazhdojë studimet në të njëjtën kohë.

Çfarë informacioni duhet t'i jepni?

Çfarë këshillash duhet t'i jepni?

Për çfarë lloj orientimi mund të ketë nevojë (duke marrë parasysh që mund të jetë duke pasur vështirësi me mësimet në shkollë)?